



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:087874
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05637683

Ac.nr.7016/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses G.B. nga Suhareka, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S.M.N., avokat në Prizren, kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensim i ushqimit gjatë punës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.741/21, të datës 27.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.741/21, i datës 27.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren–Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.741/21, i datës 27.09.2022, ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses G.B. nga Suhareka. II. DETYROHET e paditura Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës që paditëses G.B., që në emër të ushqimit në vend të punës nga data 01.01.2020 deri me datë 31.12.2020 të i’a paguaj shumën e përgjithshme prej 264.00 euro me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive dhe atë në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. III. DETYROHET e paditura që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumën prej 124 € (njëqind e njëzetë e katër) euro në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, dhe të ndryshohet aktgjykimi i atakuar C.nr.741/21, i datës 27.09.2022, ashtu që të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses.

Paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në ankesë me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 07.05.2021, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensim të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës. Në padi ka parashtruar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në Institucionin arsimor “Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza”, në Prizren, dhe e njëjta gjatë vitit 2020, pranë të paditurës ka qenë e pranishme në punë gjithsej 132 ditë, ndërsa në bazë të nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të nënshkruar në mes të MASHT dhe SBASHK me datë 18.04.2017, e paditura ka për obligim që paditëses t’ia kompensoj ushqimin gjatë orarit të punës dhe atë 2 euro për çdo ditë të pranisë në punë. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses, dhe të detyrohet e paditura, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën nga data 01.01.2020, e deri me datë 31.12.2020, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 264.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar, me arsyet si në përgjigje në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 dhe nenin 398 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes, dhe ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.741/21, të datës 27.09.2022, me të cilën e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se në mes palëve nuk ishte kontestuese fakti se paditësja është në marrëdhënie pune pranë Qendrës Burimore për

mësim dhe këshillim “Nënë Tereza” në Prizren, e angazhuar si edukatore në çerdhe, i cili fakt vërtetohet edhe me kontratën e punës me numër protokoll Nr. 03/1048-43 të datës 02.03.2016 e lidhur me afat të pacaktuar. Gjykata përmes vërtetimeve të lëshuara nga ana e institucionit arsimor Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza ” Prizren, ka vërtetuar faktin se paditësja gjatë vitit 2020 ka prezantuar në punë gjithsej 132 ditë. Gjykata e shkallës së parë vërtetimin në fjalë e ka pranuar si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë këto dokumente janë të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimet e Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza ” Prizren ku paditësja punon, si prova me të cilat vërtetohen faktet lidhur me ditët e prezencës në punë, gjykata ia fali besimin e plotë, e nga të cilat vërtetoi faktin se për 132 ditë brenda vitit 2020, paditësi ka qenë në vendin punës.

Nga provat e cekura si më lartë dhe duke u bazuar në neni 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017, ku parashihet se “*Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore*, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se paditësja ka të drejtën që të kërkojë nga e paditura kompensimin e shpenzime të ushqimit, respektivisht shujtave ditore. Duke u nisur nga fakti se e paditura paditëses nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të paraparë me dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit e detyroi të paditurën si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë për 132 ditë të pranisë në punë të ia paguaj shumën prej nga 2 euro për secilën ditë, gjegjësisht shumën e përgjithshme prej 264 euro.

Rrjedhimisht si të thënat më lartë, Gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor. Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”. Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që ka vlerësuar së në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës. Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 449, 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plot me arsyet e dhëna në aktgjykim, dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim e aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për marrjen e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore siç parashihet me nenin 398 të LPK-së, pasi që e paditura përmes përgjigjes në padi nuk e ka kontestuar gjendjen faktike dhe së në këtë rast nuk kanë ekzistuar pengesa tjera për dhënien e vendimit meritore. Ndërsa gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, ku në bazë të vërtetimit me numër të protokollit 37/2021, të datës 23.04.2021, të lëshuar nga Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” në Prizren, është vërtetuar së paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në QBMK “Nënë Tereza”, si edukatore në qerdhe, dhe vazhdon të punoj, dhe gjatë vitit 2020 ka gjithsej 132 ditë të pranisë në punë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*

Gjykata e Apelit vlerëson se kërkesëpadia e paditëses lidhur me kompensimin e ushqimit gjen mbështetje në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK-ku, dhe ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit datë 18.04.2017, ku është paraparë së *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë . Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore”*. Duke pasur parasysh se paditësja gjatë vitit 2020, ka gjithsej 132 ditë të pranisë në punë, në këtë rast Gjykata e Apelit, pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë që paditëses t’i njihet kompensimi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, pasi që gjykata

e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në përputhje me dispozitën e sipërcituar lidhur me të drejtën e paditëses për kompensimin e ushqimit, e që aktgjykimi është marrë në mënyrë të ligjshëm dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë pasi që janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për marrjen e të njëjtit sipas nenit 398 të LPK-së.

Sa i përket pretendimit së paditësja nuk i ka shterur mjetet e brendshme para se të dorëzohet padia në gjykatë siç parashihet me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, Gjykata e Apelit, vlerëson së e paditura ka pasur për obligim që paditësja t'ia bëjë kompensimin e ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punë pa pasur nevojë që paditësja t'i drejtohet të paditurës me kërkesë, dhe së në rastet kur kemi të bëjë me kërkesat në para, siç është rasti konkret, mos parashtrimi i kërkesës tek punëdhënësi nuk paraqet pengesë që i punësuari, në këtë rast paditësja për realizimin e të drejtës së saj t'i drejtohet gjykatës me padi. Ndërsa lidhur me pretendimin së kërkesa e paditësës është parashkruar, Gjykata e Apelit gjeti së ky pretendim nuk qëndron, pasi që në bazë të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, është paraparë së *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 - vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në rastin konkret paditësja përmes padisë ka kërkuar kompensimin në emër të ushqimit për ditët e prezencës në punë për periudhën nga data 01.01.2020, deri me datë 31.12.2020, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë me datë 07.05.2021, e që rezulton së nuk kanë kaluar 3 vite në mënyrë që kërkesa të parashkruhet.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje të plotë me dispozitën nga neni 382 paragrafët 1 dhe 2 të LMD-së. Po ashtu vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449, 452.1, dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7016/2022, datë 23.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci